

PËRGGJIGJE DHE REAGIM I EMISIONIT JETA NË KOSOVË

Energjia solare është shumë e mirë, por jo me çdo kusht. Emisioni ynë “Monopoli me dritë të diellit” nuk flet për gjithë energjinë solare, sepse atë mund ta investojë e prodhojë secili, mirëpo kemi bërë emision vetëm për pjesën e energjisë që merr ndihmë shtetërore, të cilën rrjedhimisht e financon konsumatori. Nuk është e mirë nëse ne duhet të paguajmë barrën e monopolit që do të reflektohet përmes faturave të rrymës tri herë më shumë se që paguan një konsumator gjerman për energji të ripërtëritshme.

Energjia prej hidrocentraleve është më e mirë se prej qymyrit, por jo me çmimin që qytetari i Kosovës ta kërrusë kurrizin përballë investitorëve që po ua dhunojnë lumenjtë e po ua shkatërrojnë ambientin në emër të energjisë së ‘pastër’.

Vetëm pse energjia është e pastër, nuk do të thotë që ju që po abuzoni me të jeni të pastër.

Kjo është arsyeja pse qytetarët po dalin në rrugë e po protestojnë kundër këtyre investimeve. Kjo ka ndodhur në Pejë me aktivistët e “Mos ma prek Lumbardhin”, në Deçan me aktivistët e “Pishtarët” dhe në Biti e Shtërpce ku janë stopuar punimet pikërisht pse po dhunohen lumenjtë e ambienti, e jo për shkak të fajit të emisionit “Jeta në Kosovë”.

Më konkretisht, hulumtimi ynë siç po shihet edhe nga vet titulli dhe përmbajtja, nuk e sulmon energjinë e ripërtëritshme siç po pretendon Shoqata për Energji të Ripërtëritshme, SHERK, por e ekspozon monopolin që po mundohet të krijohet në këtë industri, monopol i cili, për çudinë tonë, qenka i përkrahur nga SHERK, një shoqatë që do të duhej ta mbronte parimin e krijimit të një klime sa më konkurrense për gjithë investitorët e energjisë së ripërtëritshme, e jo krijimin e monopoleve.

Ky emision shpalosi dëshmi që ky monopol po krijohet duke e zbuluar skemën se si një investitor i vetëm është në rrugë për të mjelë tarifën nxitëse nga konsumatori i rrymës në Kosovë për më shumë se gjysmën e megavatëve të dedikuar për energji solare. Për ta mjelë këtë tarifë nxitëse sa ma shumë, ky investitor i ka regjistruar 5 kompani në Maltë duke e fshehur pronarin e vërtetë të tyre në aplikimin që ka bërë në ZRR në Kosovë.

Po të kishte qenë hulumtimi jonë aq joprofesional e folklorik si po thotë në reagimin e tyre edhe SHERK edhe Devolli Group, ky hulumtim nuk do të kishte sjellë::

- a) Njoftimin se Prokuroria Speciale po bën grumbullimin e informacioneve për hetim;
- b) Konstatimin e Komisionit për Ndihmë Shtetërore që ZRrE-ja ka bërë shkelje të ligjit dhe njëkohësisht të nisë hetime;
- c) Nisjen e hetimeve nga Agjencia Kundër Korrupsionit për konfliktin e mundshëm të interesit
- d) Reagimin e ekspertëve të fushës në favor të gjetjeve të emisionit që veçse e përforcojnë argumentin e hulumtimit që kemi prezantuar.
- e) Kërkesën që ka bërë Vjosa Osmani, kryetarja e Kuvendit të Kosovës, që me urgjencë Komisioni për ekonomi, ekonomi, punësim, tregti, industri, ndërmarrësi dhe investime strategjike ta trajtojë lëndën më prioritet dhe të ndërmarrin hapat e duhura në përputhje me të gjeturat e hulumtimit të BIRN.

Në fakt, reagimi i SHERK është dërguar te të gjitha mediat e Kosovës (ndoshta edhe më gjerë) në përpjekje të shoqatës për ta “shitur” versionin e vet të monopolit, në vend se ky reagim të dërgohej në redaksinë tonë meqë ne jemi publikuesit e hulumtimit.

Për më shumë, reagimi i Shoqatës SHERK nuk qëndron ngase nuk është vetëm emisioni ynë që nxit dyshime për skemën korruptive të tarifave nxitëse të ZRrE-së por këtë e ka ngritur edhe Ambasada gjermane, USAID, Komisioni Evropian dhe ekspertët e Komitetit të Energjisë në Vjenë që i intervistua në emision.

Në anën tjetër, puna që ka bërë Jeta në Kosovë, që ekziston shumë përpara SHERK-ut, është shumë më transparente se puna që ka bërë SHERK. Ne i kemi në faqen tonë të internetit me dhjetëra emisione e artikuj që promovojnë energjinë e pastër si dhe ballafaqimet me liderë të rajonit dhe Evropës ku me këmbëngulësi kemi insistuar te hapja e lidhjes së transmisionit energjetik me Shqipëri në mënyrë që mos Kosova të varet nga importi i Serbisë.

Por SHERK-u, kjo alamet shoqate, e ka mbyllur edhe atë pak faqe interneti që e ka pasur kur është themeluar, <http://sherk.net/>, kështu që qytetari nuk ka nga ta ta dijë se kush na qenkan këta anëtarë të SHERK-ut dhe kush është bordi i tyre patriotik që po ndihet kaq i ofenduar prej hulumtimit tonë. Pasi SHERK po i fsheh anëtarët, ndoshta, edhe ata duhet t'i kërkojmë në Maltë, pasi që në Kosovë faqja e tyre është e vdekur.

Normal që nuk është çudi që organizatat që i fshehin emrat e njerëzve që qëndrojnë prapa tyre kanë arsye të frikësohen prej emisioneve e hulumtimeve tona.

E pikërisht kjo organizatë fantome ka reaguar me një e-maili sherk.ks@yahoo.com, dhe reagimi i tyre i titulluar “Jeta Xharra favorizon importin e energjisë nga Serbia” është jo vetëm folklorik por edhe fyes, i pabazuar dhe përbën sulm direkt ndaj gazetarisë në Kosovë. Pretendimi se kush i sulmon këto biznese të Devollit është për Serbinë është tendencë që duke u thirrur në patriotizëm ata të vjedhin nga xhepi i qytetarëve. Në fakt, këto kompani kanë problem me patriotizmin e tyre ngase janë duke bërë të kundërtën e asaj që kanë sugjeruar shtetet që e kanë çliruar Kosovën, shtetet ku janë të bazuara USAID, Ambasada Gjermane e Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë të cilët i kanë sugjeruar Kosovës të MOS e bëj licencimin e energjisë diellore në këtë formë por të bazohet në konkurrencë.

Në fakt ky titull është parullë e lodhtë prapa të cilës patriotat falls të SHERK-ut duan të fshihen sepse nuk dinë ndryshe si ta arsyetojnë para qytetarit se pse ata po e dashkan aq shumë Kosovën sa duhet t’ia falin gjysmën e megavatëve të solareve një njeriu, dhe aq e madhe qenka dashuria e tyre për dheun e Kosovës sa e dhunojnë ujin, lumin, tokën, florën e faunën në baza të rregullta me hidrot e tyre kundër të cilave qytetari është duke u kryengrit.

Emisioni kërkon që përfitues të tarifave nxitëse të mos jenë bizneset e listuara, por kjo të bëhet përmes ankandit, si në gjithë rajonin. A nuk do të duhej që anëtarët e SHERK-ut të mendonin njëjtë, apo edhe aty ka monopol një njeri?

Duket që SHERK po përfaqëson investitorët e egër që i kanë marrë erë tarifës nxitëse si ujku kopesë së deleve, e nuk çajnë hallin as për qytetarin që i vidhet lumi dhe as për konsumatorin që e ngarkojnë me tarifë 3 herë më të madhe se në Gjermani. E kur u ekzpozohet kjo egërsi, ata s’po dinë tjetër pos të na akuzojnë se qenkemi ‘të Serbisë’ e ata na qenkan ‘të Kosovës’. Ka kaluar koha kur ky “argument” pinte ujë në Kosovë. Ujin s’o tu na e pi më Serbia, por ju!

Mu për shkak se reagimi i SHERK ishte aq i paftyrë i pabazë fyes e shpifës, Oda Ekonomike e Kosovës u distanca nga ky qëndrim.

Pra, Kosova duhet të zhvillojë investime në energji të pastër në atë formë që nuk krijon monopol dhe në atë formë që nuk bën dëm në ambient dhe në mirëqenie të qytetarëve që varen nga lumenjtë pranë të cilëve jetojnë dhe që nuk ngarkohen konsumatorët për

përfitim të investitorëve. Thjesht, gjithë ekspertët dhe qytetarët po e thonë që Kosova nuk ka aq shumë lumenj që të ketë hesap t'i fusë në gypa dhe ky argument tash pranohet prej të gjithëve përveç prej SHERK e atyre që duan me çdo kusht ta mjelin këtë lopë të shterrë.

Lidhur me argumentin se ne në emision e kemi kalkuluar keq analizën tonë financiare që lidhet me tarifën nxitëse ne kemi plot argumente që tregojnë që SHERK e Devolli Group e kanë kalkulimin paushall, jo ne!

Së pari, ne mendojmë se për publikun, dmth për konsumatorët, është me rëndësi të analizohet se sa po paguhet për energji të ripërtrishme, solare në këtë rast, në krahasim me çmimin e tregut, pavarësisht skemës se si caktohet ai çmim. Dallimi është faktik, dhe i drejtë apo jo, i pranueshëm apo jo, konsumatorët duhet ta dinë sepse është xhepi i tyre që preket.

Pajtohem se krahasimet me tarifën e vendeve tjera nuk mund të jetë gjithnjë proporcionale por gjithsesi do të ishim të padrejtë ndaj publikut dhe konsumatorëve nëse nuk do të bënim këto përafrime dhe krahasime. Pra, atë që nuk e pranojmë është që t'ju japim juve, investitorëve të SHERK-ut dhe të Maltave, ekskluzivitetin që të jeni udhërrëfyesi se sa duhet të paguhet çmimi i rrymës, e as që do ta pranojmë që ta marrim si të mirëqenë që këtë çmim mund ta dinë e vendosin vetëm një grusht byrokratësh në ZRrE, të cilët siç thamë në emision, nuk e kanë përmbushur kriterin profesional, sipas rekrutuesve britanikë, që të bëhen pjesë e bordit të ZrRE-së.

Asnjëri prej jush që keni reaguar s'jeni për mashallah që me ju besu fjalës suaj për çmime të rrymës. Fundja, kërkesa bazike e gjitha palëve që i kemi cituar në emision ka qenë që çmimin ta përcaktojë tregu, pra përmes konkurrencës e jo përfituesit të jenë bizneset e listuara duke u bazuar në një "listë të pritjes" që sipas përfaqësuesit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë është E KUNDËRLIGJSHME.

Devolli Group në reagimin e tyre flet për konceptin e ekonomisë së shkallës (economy of scale) dhe pastaj tregon si institucionet financiare ndërkombëtare nuk përkrahin projekte me kapacitet më të vogël se 10 megavat. Por, ata e pranojnë që mbrapa 4 bizneseve të regjistruara në Maltë është Blerim Devolli dhe kapaciteti i këtyre 4 kompanive është 10.73 megavat. Pra, a nuk do të duhej që ZRrE-ja të kalkulonte çmimin e tarifës nxitëse duke u bazuar në projekte 10.73 megavat, pra duke u bazuar në konceptin e ekonomisë së shkallës dhe duke marrë parasysh se projekte të tilla mund të sigurojnë financim edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare? Pra, sa do të dilte tarifa nxitëse në projekte 10 megavatëshe, sepse qysh kanë thënë Devolli Group

në reagimin e tyre “logjikisht prodhuesit e paneleve dhe pajisjeve tjera ofrojnë çmime më të lira për projekte më të mëdha”? Ose pyetja mund të shtrohet ndryshe, sa është dëmtuar konsumatori në këtë rast dhe a janë diskriminuar bizneset që e kanë veç një kompani e veç 3 megavat, duke marrë parasysh që ata s’e kanë bërë dredhinë që e ka bërë Devolli Group, të regjistrojnë 4 kompani në Maltë e të aplikojnë në Kosovë duke i ‘fitu’ 16.7 megavat?

Në asnjë vend në emision nuk thuhet se edhe ankandi ka qenë dashur të jetë për kapacitete prej 3 megavat, njëjtë siç nuk është thënë nëse Kosova duhet apo nuk duhet t’i ofrojë investitorëve tokë ose edhe infrastrukturë përcjellëse. Pra, fryma e emisionit është pse të ngutemi dhe pse të mos shkojmë me ankand, pyetje që po i brengos edhe ekspertët e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Ne si media jemi pushteti i katërt, të pavarur prej shtetit, parlamentit, gjyqësisë, agjencive dhe të pavarur prej juve, sektorit privat, dhe është roli i ynë të bëjmë kalkulimet tona e ta informojmë publikun për një temë të tillë që ndikon në shpenzimet e amvisërisë. Kukulimet tona në fakt s’kanë pikur prej qiellit por janë bazuar në shifrat që na kanë dhënë Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vienë dhe ZRE-ja.

Për më tepër, krahasimet janë bërë gjithnjë duke vënë në pah procedurën që është aplikuar në rastet tjera, rezultat i së cilës vazhdon të jetë, presioni i theksuar në çmimet e ofruara nga investitorët. Dmth, ku janë aplikuar procedurat konkurruese, çmimet janë më të ulëta dhe ka përaftrim gjithnjë e më të madh me çmime të tregut në përgjithësi, përderisa vendosja administrative e tarifave ka dhënë çmime shumë më të larta. Kjo është e evidente dhe e botërisht e pranuar. Pikërisht kjo thuhet edhe në linkun të cilit i jeni referuar në reagimin tuaj.

Kur jemi të krahasimet, mendojmë se jeni të padrejtë dhe mosperfillës ndaj një fakti shumë të rëndësishëm rreth financimit të burimeve të ripërtëritshme. Në shumicën e vendeve evropiane e dhe përtej, tarifat për burimet e ripërtëritshme financohen edhe nga burime tjera (psh. nga taksat e ndryshme, buxheti, etj) dhe jo gjithçka bie në krahun e konsumatorëve siç është rasti i Kosovës.

Përveç kësaj, edhe parametrat makroekonomikë shpërfaqin një barrë të rëndë për konsumatorët kosovarë krahasuar me ata Gjermanë. Kjo mund të shihet prej rangimit që ka bërë pas emisionit, Adhurim Haxhimusa, që ka doktoruar në çështjen e energjisë dhe po punon në *Universitetin e Shkencave të Aplikueshme të Graubünden (FHGR) në Zvicër. Analiza e tij financiare, as e jona e as e SHERK-ut thekson se “Gjermania*

paguan vetëm 0.75% të bruto prodhimit vendor (BPV) (për energji të ripërtitshme), ndërsa Kosova mbi 2.02%. Pra, qytetari kosovar mesatar është i ngarkuar 2.7 herë më shumë se qytetari gjerman mesatar.”

Për neve mbetet e paqartë se pse kjo nuk e shqetëson pjesën e anëtarësisë së SHERK-ut që përfaqëson bizneset konsumuese të energjisë elektrike.

Apo, nëse ky doktor shkence në energji që është lajmëruar pas emisionit nuk po ju shkon për shtati, a keni ju ndonjë doktor shkence në botë që ka reaguar pas emisionit duke e përkrahur analizën tuaj financiare?

Një fakt tjetër që gjithashtu neglizhohet në reagimin tuaj është mënyra se si përcaktohet çmimi. Insistimi ynë në praktikat që kanë dhënë rezultate, gjithnjë në të mirë të konsumatorëve, është më se i drejtë. Implementimi i procedurave konkurruese në marrjen e kapaciteteve solare (20 megavat) me siguri do ta kursente konsumatorin nga pagesat shtesë, do të na kursente ne nga krahasimet potencialisht joproporcionale, e edhe ju nga shpërfaqja e mospërfilljes ndaj konsumatorëve.

Mbase, do ta kursente edhe Prokurorinë Speciale nga nisja e hetimeve. Shpresojmë për këtë të fundit jeni të informuar.

Duke qënë se përfaqësoni anëtarësi biznesi, e edhe investitorë në sektorin e energjisë, është e çuditshme se si në reagimin tuaj nuk kishte asnjë fjalë të vetme dhe insistim në aplikimin e procedurave transparente dhe konkurruese, që marrin për bazë çmimin e ofruar nga investitori potencial, në alokimin e kapaciteteve dhe përkrahjes përkatëse. Vetëm kjo do të siguronte shpërndarjen të drejtë të mirëqenies ekonomike mes prodhuesve dhe konsumatorëve. Pra, ne jemi për procedura që stimulojnë konkurrencën dhe nuk diskriminojnë investitorët potencialë, e edhe përkrahje ku konsumatorëve u ngarkohet çmimi më i mirë i arritur. E ju për çka jeni? Ne nuk kemi raportuar e avokuar për më pak se çka do t'u takonte investitorëve potencialë mbi bazën e konkurrencës, e as për më shumë se çka konsumatorët do duhej të paguanin.

Së fundi, edhe reagimi i SHERK e edhe i Devollit po e kritikon ekipin e “Jeta në Kosovë” si ekip që ‘...i mungon tërësisht kompetenca në sferën e ekonomisë’, ka “..mungesë të njohurive themelore në sektorin energjetik” dhe “..imponohet si gazetare hulumtuese”. T’ju përkujtojmë, ne kemi punuar hiç më pak se 4 muaj për të mbledhur informatat e sakta në këtë hulumtim. Ekipi që ka punuar në këtë hulumtim janë Visar Prebreza,

ekonomist dhe ekspert i certifikuar i forenzikes financiare, i cili në të kaluarën ka zbuluar skemën e shitjes ilegale të hidrocentraleve të Kosovës dhe si rezultat i atij hulumtimi sot 19 persona, duke përfshirë 4 ish-ministra, kanë aktakuzë për atë rast. Nga ana tjetër, Jeta Xharra ka dy dekada karrierë në gazetari hulumtuuese, ka punuar për BBC, ka shkruar New York Times dhe i ka dy magjistratura nga Mbretëria e Bashkuar (Kings College). Nëse nuk merret vesh edhe ajo fare në ekonomi, pse atëherë janë ngritur dy aktakuza për hulumtimin që e ka bërë ajo për vjedhjen e organizuar tatimore që është bërë me faktura fiktive të ATK-së.

Blerim Devolli, që na qenka kaq i përgatitur për aspekte të energjisë (të birrës, të qumështit, të kosit, e të langeve, amortizatorëve e telefonisë), sipas LinkedIn-it e ka kryer fakultetin në Univerzitetin Kristal në Tiranë, universitet që është mbyllur në 2014 nga Ministria e Arsimit në Shqipëri për shkak të skandaleve. Kosova nuk e ka parë Blerim Devollin duke argumentuar politika energjetike (për të cilat ai po na akuzon ne nuk po i ditkemi) por Kosova e ka parë Blerim Devollin tek përgjigjet para deputetëve për kontratën me Telekomin e Kosovës për Z-Mobile, duke kërkuar që mediat të dalin jashtë se ai nuk preferon të flas hapur e me transparencë para publikut të Kosovës. Kosova poashtu e njeh Blerim Devollin si nikoqir i mirë në jahtin e tij në Budvë që i shërben politikanët e Kosovës me 'Coca Cola zero'. E qartë që Kosova e njeh Blerim Devollin edhe si punëdhënës i madh në Kosovë, shumë faleminderit për këtë, por kjo s'i jep të drejtë ati ta ngris veten në pidiestalin e diturisë për energji duke na nënvlerësuar ne sepse siç po shihet, ai nuk ka ndonjë kualifikim më të lartë se ne në këtë fushë. Milionat s'e bëjnë njeriun të ditur dhe mungesa e milionave s'na bën as ne të paditur.

Dorën në zemër, kapaciteti i Blerim Devollit, në krahasim me ne, që të bëj fiskultura me regjistrim, çrregjistrim, rimërim, shpërndarje e ndarje të kompanive me vllazni është shumë më i avancuar se sa imagjinata e ekipit tonë andaj ne i gëzohemi çdo reagimi të tij, sepse çdo reagim i tij, sado modest, gjithmonë na ka ndihmuar të zbulojmë pista të reja për t'i hulumtuar. Andaj e falenderojmë edhe për reagimin e fundit ku ka theksuar që ka kompani tjera përveç këto të tijat, kompani me të njejtin pronar, që po marrin tarifë nxitëse nga shteti i Kosovës! Kjo është informatë mjaft e vlefshme që na e ka dhënë Devolli Group në reagimin e tyre të fundit dhe për këtë jemi falenderues dhe po e hulumtojmë tutje.

Së fundi ju inkurajojmë që të angazhoheni në diskutim me ne kur u dërgojmë pyetje siç i kemi dërguar Devolli Group-it prej shkurtit e deri në prill. Është e habitshme që atëherë s'keni qenë në disponim për reagim e pas emisionit keni shkruar reagim të gjatë për kalkukimet tuaja. Këshillën mediale dhe këshillën për (mos)angazhim në debat publik e keni të dobët. Sido që ta keni kalkuluar, ne mendojmë që nëse doni të zhvilloni biznes

të drejtë në Kosovë duhet të angazhoheni në diskutim me njerëz që nuk i keni medeomos nën kontroll dhe të debatoni me njerëz që nuk i keni në rrogë. Ne e çmojmë mendimin e palës së kundërt dhe po ju ritheksojmë që keni hapësirë që argumentet që i keni thënë në reagimet tuaja t'i thuani edhe në emisionet tona dhe ne do ju sfidojmë me këto pyetje që ju kemi shtruar edhe në këtë reagim. Pra shumë e thjeshtë, nëse mendoni që me të vërtetë keni dituri në energji më shumë se ne, matuni me dije në një debat me ne, kurdo që ju të jeni gati. Dialogu është gjithmonë më efektiv se monologu që po e zhvillonin me reagime nëpër media që po i zgjedhni ju, pas publikimit të hulumtimit tonë, e jo gjatë procesit të hulumtimit.

Sidoqoftë, ne jemi gjithmonë falenderues për reagimet tuaja, (sado të parashikueshme, të cekëta e fyese që janë ato),

Ekipi i Emisionit “Jeta në Kosovë”